


F

E nderuar trupë gjyquese e Kolegjit të Apelit,



Në ushtrim të së drejtës që i njihet nga pika 5 e nenit 179/b të Kushtetutës, pika 2 e nenit C, pika 2 e Nenit F të Aneksit kushtetues dhe nenit 63 të ligjit nr.84/2016 "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", brenda afatit ligjor, Komisioneri Publik ka ushtruar ankim kundër vendimit nr.02, datë 16.02.2018 të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit për subjektin e rivlerësimit z. Adriatik Llalla.

Po ju paraqes në vijim një përmbledhje të shkaqeve të ankimit.

Z Adriatik Llalla ka ushtruar detyrën e Prokurorit të Përgjithshëm nga data 07.12.2012 deri në datë 18.12.2017, kur me vendimin nr.115/2017 Kuvendi i Shqipërisë zgjodhi Prokurorin e Përgjithshëm të Përkohshëm.

Në zbatim të dispozitës së pikës 3 të nenit 179/b të Kushtetutës dhe pikës 4 të nenit 4 të ligjit nr.84/2016 "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", z Adriatik Llalla është subjekt i rivlerësimit.

A handwritten signature in blue ink, appearing to read "Anisa Bellay", with several horizontal lines drawn through it.

Nisur nga detyrimi i sanksionuar në ligjin nr.84/2016, ka rezultuar se z Adriatik Llalla, gjatë kohës që ushtronte funksionin e Prokurorit të Përgjithshëm ka dorëzuar pranë strukturave përgjegjëse, deklaratën e pasurisë, deklaratën për kontrollin e figurës dhe formularin e vetëvlerësimit profesional.

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit ka nisur procedurën e rivlerësimit ndaj subjektit të rivlerësimit z Adriatik Llalla në datë 06.11.2017, datë në të cilën është shortuar trupa gjyquese. Kjo e fundit prej asaj date ka kryer një sërë veprimesh hetimore, të dokumentuara në fashikullin përkatës.

Ndërkohë që ndaj tij kryheshin veprime hetimore sipas ligjit nr.84/2016, rezulton se pas miratimit të vendimit të Kuvendit të Shqipërisë për zgjedhjen e Prokurorit të Përgjithshëm të Përkohshëm, z Adriatik Llalla në datë 24.01.2018 i është drejtuar me një akt të shkruar të titulluar “shkresë informuese” Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, në vëmendje të kryetares së këtij Komisioni.

Në këtë shkresë, z Adriatik Llalla ka pretenduar se nuk është më subjekt i ligjit për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe

prokurorëve dhe aq më pak bën pjesë në rrethin e subjekteve prioritare, sipas nenit 4 të ligjit nr.84/2016.

Këtë pretendim të tij, z Adriatik Llalla e mbështet në interpretimin që i bën nenit 179/b të Kushtetutës, përsa kohë sipas tij mosushtimi më i detyrës së Prokurorit të Përgjithshëm nuk legjitimon vijimin e procedurave të rivlerësimit.

Në përgjigje të shkresës së z Adriatik Llalla, të datës 24.01.2018, kryetarja e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, më datë 01.02.2018 ka kthyer një përgjigje zyrtare.

Në referencë të përmbajtjes së kësaj shkrese, Kryetarja e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, ka informuar z Adriatik Llalla se në zbatim të nenit 148/a, pika 5 e Kushtetutës, edhe pas mbarimit të mandatit si Prokuror i Përgjithshëm, ai vijonte të gëzonte statusin e magjistratit. Neni 148/a, pika 5 e Kushtetutës sanksionon të drejtën e subjektit që mbaron mandatin si Prokuror i Përgjithshëm, që me kërkesën e tij të emërohet gjyqtar në gjykatën e apelit.

Në këto rrethana ligjore, duke qenë një subjekt që gëzon statusin e magjistratit, Kryetarja e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i bën me dije z Adriatik Llalla se procedurat e rivlerësimit kalimtar ndërpriten vetëm në zbatim të nenit G të Aneksit të Kushtetutës, në rastet kur magjistrati, gjyqtar/prokuror, jep dorëheqjen. Ky argument, mbështetet dhe në arsyetimin e vendimit të Gjykatës Kushtetuese nr.78/2017.

Në këtë shkresë të saj, të datës 01.02.2018, Kryetarja e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, e referon subjektin e rivlerësimit z Adriatik Llalla tek përmbajtja e nenit 56 e ligjit nr.84/2016, ku brenda një afati tre mujor nga hyrja e ligjit në fuqi, subjektet e rivlerësimit, lejoheshin të paraqisnin dorëheqjen pranë Presidentit të Republikës.

Pas marrjes dijeni të kësaj shkrese të Kryetares së Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, nga subjekti i rivlerësimit z Adriatik Llalla, në Institucionin e Presidentit të Republikës, me nr.381 prot., datë 12.02.2018 është protokolluar një akti i shkruar i titulluar "kërkesë për dorëheqje".



Në këtë këtë akt të titulluar “kërkesë për dorëheqje”, drejtuar Presidentit të Republikës, duke iu referuar nenit 56 të ligjit nr.84/2016 dhe vendimit nr.78/2017 të Gjykatës Kushtetuese, subjekti nënshkrues është shprehur se paraqet dorëheqjen nga funksionet e magjistratit.

Në datë 12.02.2018, subjekti i rivlerësimit, rezulton t’i jetë drejtuar sërish Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, në vëmendje Kryetares, me një akt të shkruar të titulluar “Kërkesë”.

Në këtë kërkesë, subjekti i rivlerësimit z Adriatik Llalla, duke iu referuar shkresës kthim përgjigje nga Kryetarja e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit të datës 01.02.2018, ka bërë me dije se bazuar në nenin 56 të ligjit nr.84/2016 dhe vendimin nr.78/2017 të Gjykatës Kushtetuese ka hequr dorë nga statusi i magjistratit, duke paraqitur dorëheqjen pranë Presidentit të Republikës.

Konstatohet se në të njëjtën datë, pra 12.02.2018, Institucioni i Presidentit të Republikës, me shkresën nr.381/1 prot., i ka përcjellë kryetares së Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, kopje



origjinale të kërkesës për dorëheqje nga funksionet e magjistratit, paraqitur nga subjekti i rivlerësimit z Adriatik Llalla.

Rezulton se mbi këtë bazë dokumentare, trupa gjykuese e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, me vendimin nr.02, datë 16.02.2018, ka vendosur të deklarojë se procesi i rivlerësimit ndaj subjektit z Adriatik Llalla është ndërprerë.

Ky vendim rezulton të jetë mbështetur në arsyetimin se dorëheqja e paraqitur nga subjekti i rivlerësimit/magjistrat, në vështrim të nenit G të Aneksit të Kushtetutës, nenit 56 të ligjit nr.84/2016 dhe vendimit nr.78/2017 të Gjykatës Kushtetuese, sjell si pasojë ndërprerjen e procesit të rivlerësimit.

E nderuar gjykatë,

në opinionin e tij të dhjetorit 2015, mbi ndryshimet kushtetuese në Republikën e Shqipërisë, Komisioni i Venecias shprehet se domosdoshmëria e procesit të vettingut shpjegohet me prezumimin se niveli i korrupsionit në gjyqësorin shqiptar është ekstremisht i lartë dhe se situata kërkon marrjen e masave urgjente dhe radikale.



Rikthimi i besimit të publikut tek organet e sistemit të drejtësisë mbetet një ndër shkaqet kryesore të kryerjes së procesit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve, dhe Komisioneri Publik në këtë proces ka për detyrë kushtetuese të përfaqësojë interesin publik.

Interesi Publik në kryerjen e procesit të rivlerësimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve, përkthehet në nevojën që ky proces të përmbushë plotësisht procedurat e parashikuara në Kushtetutë dhe në ligjin nr.84/2016, në harmoni me gjithë legjislacionin tjetër që rregullon funksionimin e sistemit të drejtësisë dhe garanton liritë dhe të drejtat e individit.

Nga ky proces rivlerësimi, magjistrati mund të konfirmohet në detyrë në qoftë se i kalon me sukses të tre elementët e vlerësimit, atë të pasurisë, figurës dhe përgatitjes profesionale.

Nga ky proces rivlerësimi, magjistrati mund të shkarkohet, në qoftë se nuk kalon qoftë dhe njërin nga elementët e rivlerësimit.



Por kushtetutëbërësi ka parashikuar dhe një mundësi të tretë për magistratët dhe gjithë subjektet e tjera të rivlerësimit.

Të mos i nënshtrohen procesit të vettingut.

Të ikin vetë nga sistemi i drejtësisë.

Të ikin, duke dhënë dorëheqjen.

Dorëheqja e magistratit, në referencë të nenit G të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, sjell si pasojë ndërprerjen e procesit të rivlerësimit kalimtar.

Pasoja e dytë që sjell dorëheqja e magistratit, sipas nenit G të Aneksit Kushtetues, është ndalimi për 15 vjet që subjekti të emërohet gjyqtar ose prokur i çdo niveli, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor ose të Prokurorisë, Inspektor i Lartë i Drejtësisë ose Prokuror i Përgjithshëm.

Në rastin konkret, z Adriatik Llalla supozohet se ka zgjedhur të mos i nënshtrohet procesit të rivlerësimit kalimtar, duke ushtruar të drejtën që i njeh neni G i Kushtetutës, dorëheqjen.

Por, në vlerësimin e Komisionerit Publik, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit nuk ka qenë në rrethanat ligjore, që e lejojnë të vendoste ndërprerjen e procesit të rivlerësimit për z Adriatik Llalla.

Z Adriatik Llalla nuk i kish mbaruar statusi i magjistratit në datë 16.02.2018, datë kur është dhënë vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

Z Adriatik Llalla gëzon statusin e magjistratit.

Këtë status z Adriatik Llalla e ka fituar duke qenë në detyrën e Prokurorit të Përgjithshëm, ditën kur hynë në fuqi ndryshimet kushtetuese dhe ligji nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Neni 148/a, pika 5, neni 179, pika 10 e Kushtetutës, neni 2, gërma “gj”, neni 164, pika 1, gërma “b” i ligjit nr.96/2016 janë të qartë teksa i njohin statusin e magjistratit të gjithë gjyqtarëve dhe prokurorëve në detyrë, përfshirë Prokurorin e Përgjithshëm, duke i njohur këtij të fundit në mbarim të mandatit edhe të drejtën për t’ u emëruar si gjyqtar në gjykatë apeli.



Ky status i fituar i magjistratit, mbaron vetëm në rastet e parashikuara në ligjin nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, duke u zbatuar rigorozisht procedurat përkatëse ligjore.

Neni 64, pika 1, gërma “a” e ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” parashikon si njërin nga shkaqet e mbarimit të statusit të magjistratit, rastin kur gjyqtari ose prokurori jep DORËHEQJEN.

Neni vijues, neni 65 i po këtij ligji parashikon shprehimisht se dorëheqja i paraqitet Këshillit të Lartë Gjyqësor ose Këshillit të Lartë të Prokurorisë, i cili deklaron me VENDIM mbarimin e statusit të magjistratit.

Dorëheqja jepet edhe gjatë kohës që është duke u kryer procesi i rivlerësimit. Magjistratët, gjyqtarë e prokurorë, mund ta japin dorëheqjen për të mos iu nënshtruar procesit të vettingut, sipas nenit G të Aneksit të Kushtetutës.



Por, dorëheqja e magjistratit është dhe duhet të konsiderohet një institut ligjor, që gjen rregullim vetëm në dispozitat e ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Çdo magjistrat që jep dorëheqjen, qoftë dhe me qëllim për t’ i ikur procesit të vettingut, duke të paraqesë dorëheqjen pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor ose Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

Por në rrethanat aktuale kur këto këshilla ende nuk janë ngritur si duhet të veprohet?

Ligjvënësi e ka dhënë zgjidhjen, teksa ka parashikuar në dispozitat kalimtare të ligjit nr.96/2016, neni 160, të drejtën respektivisht të Këshillit të Lartë të Drejtësisë dhe Prokurorit të Përgjithshëm të deklarojnë mbarimin e statusit për gjyqtarët dhe prokurorët, në rastet kur ata paraqesin dorëheqjen.

Në rastin konkret, z Adriatik Llalla nuk e ka ndjekur procedurën e parashikuar për dorëheqjen nga statusi i magjistratit, sipas ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.



Kërkesën për dorëheqje nga statusi i magjistratit z Adriatik Llalla duhet t' ia kishte drejtuar Këshillit të Lartë të Drejtësisë dhe ky i fundit të deklaronte me vendim mbarimin e statusit të magjistratit.

Vetëm pasi të ndiqej kjo procedurë ligjore e parashikuar nga ligji nr.96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", Komisioni i Pavarur i Kualifikimit mund të ishte në kushtet, që referuar nenit G të Aneksit të Kushtetutës, të vendoste ndërprerjen e procesit të rivlerësimit kalimtar.

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, nuk ka ndërmarrë asnjë veprim procedural për të hetuar dhe vërtetuar në rast se kjo procedurë detyruese ligjore për paraqitjen e dorëheqjes dhe deklarimin e mbarimit të statusit të magjistratit, të ishte ndjekur në rastin e z Adriatik Llalla.

Është për t' u vënë në dukje, që në tre raste të tjera të ngjashme, vetë Komisioni i Pavarur i Kualifikimit ka vepruar ndryshe, nga sa ka vepruar në rastin konkret me subjektin e rivlerësimit z Adriatik Llalla.



Kështu, në vendimet e tij nr.08, datë 23.03.2018 për subjektin magjistrat/gjyqtar I.P, nr.10, datë 28.03.2018 për subjektin magjistrat/gjyqtar I.Ç dhe nr.11, datë 10.04.2018 për subjektin magjistrat/prokuror E.B, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit ka vendosur të ndërpresë procesin e rivlerësimit vetëm pasi ka konfirmuar dorëheqjen e subjekteve dhe mbarimin e statusit të magjistratit, nëpërmjet administrimit të vendimeve të marra nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë dhe Prokurori i Përgjithshëm i Përkohshëm, bazuar në parashikimet e ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Duam të nënvizojmë se procedura e parashikuar nga dispozitat e nenit 64 dhe 65 të ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” në lidhje me mbarimin e statusit të magjistratit për shkak të dorëheqjes dhe procedurën e administrimit të saj nuk duhet të vlerësohen vetëm në kornizën e formalizmit.

Veçanërisht, procedura e parashikuar në nenin 65 të ligjit nr.96/2016 ka një rëndësi substanciale në lidhje me verifikimin e vullnetit të subjektit për të hequr dorë nga statusi i magjistratit.



Çfarë ndodh në qoftë se procesi i rivlerësimit në rastin konkret bazohet vetëm në një kërkesë të thjeshtë për dorëheqje të paraqitur pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nëpërmjet shërbimit postar?

Kush verifikon në qoftë se kjo kërkesë për dorëheqje shpreh ose jo vullnetin e lirë të magjistratit për dorëheqje?

Kush verifikon në qoftë se kjo kërkesë për dorëheqje është nënshkruar ose jo prej magjistratit?

Një dorëheqje e paformalizuar dhe jashtë procedurës ligjore për mbarimin e statusit, por që ndërpret rivlerësimin për subjektin, sa mundësi ka që të përdoret si shkak për t' u rikthyer si magjistrat, ditën kur organet e rivlerësimit kanë mbaruar mandatin e tyre dhe procesi i rivlerësimit ka mbaruar?

Këto elementë dhe situata ligjore mund dhe duhet të verifikohen vetëm nga organet përkatëse, Këshilli i Lartë Gjyqësor/KLD ose Këshilli i Lartë i Prokurorisë/Prokurori i Përgjithshëm, ashtu siç parashikohet në ligjin nr.96/2016.



Çdo interpretim i kundërt mund të sillte pasoja të qarta pavlefshmërie të vendimeve të marra nga ana e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit duke ndikuar në këtë mënyrë thelbësisht, në cënimin e atij që përbën një ndër motivet më të rëndësishme të kryerjes së procesit të rivlerësimit, rikthimin e besimit të publikut në sistemin e drejtësisë.

Kushtetuta dhe ligji zbatohen vetëm nëpërmjet procedurave që ato vetë parashikojnë.

Çdo improvizim në zbatimin e procedurave mund të na sjellë në situata të paqarta, që u lenë vendin interpretimeve, e që mund të sjellin pasoja ligjore, sikundër verifikohen edhe në rastin konkret.

Subjekti i rivlerësimit z Adriatik Llalla, përvec se siç u tha më lart, gëzon statusin e magjistratit/gjyqtar për shkak të ushtrimit të detyrës së Prokurorit të Përgjithshëm, rezulton të mos ketë humbur për asnjë ditë edhe statusin e magjistratit/prokuror.

Z Adriatik Llalla rezulton se me Dekretin e Presidentit të Republikës nr.2298, datë 15.01.1999 është emëruar prokuror i Republikës.



Edhe pse në vitin 2008 është dhënë pëlqimi i Kuvendit për emërimin e tij Inspektor i Përgjithshëm i ILDKP, ndërsa ai vazhdonte të ishte në detyrën e prokurorit, nuk rezulton të ketë një Dekret të Presidentit të Republikës që ta ketë liruar nga funksionet e prokurorit, ashtu sikundër Kushtetuta kërkon.

Në vlerësimin tonë, edhe për këtë shkak, sot z Adriatik Llalla gëzon statusin e magjistratit/prokuror.

E në referencë të arsyetimit ligjor të mësipërm, nisur nga parashikimet e ligjit nr.96/2016, statusin e magjistratit/prokuror, z Adriatik Llalla sot e mbaron vetëm duke paraqitur kërkesë pranë, pranë Prokurorit të Përgjithshëm.

Të nderuar gjyqtarë,

Zbatimi i nenit G të Aneksit të Kushtetutës nga ana e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, duke ndërprerë procesin e rivlerësimit kalimtar të magjistratëve, gjyqtarëve dhe prokurorëve, është dhe duhet konsideruar nga pikëpamja ligjore vetëm një pasojë.

Pasojë, e cila do të duhet të japë efektet juridike të saj vetëm në kushtet kur shkak, dorëheqja e magjistratit/subjektit, të jetë materializuar dhe formalizuar sipas parashikimeve të ligjit nr.96/2016 ose legjislacionit tjetër në fuqi.

Ka qenë detyrim i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit që në rastin e z Adriatik Llalla të mos ta ndërpriste procesin e rivlerësimit, pa hetuar e verifikuar plotësimin e të gjitha procedurave ligjore të parashikuara në ligjin nr.96/2016.

Duke mos hetuar dhe verifikuar plotësimin e procedurave ligjore, në lidhje me paraqitjen e dorëheqjes dhe deklarimin e mbarimit të statusit të magjistratit, ne vlerësojmë se Komisioni i Pavarur i Kualifikimit në momentin e dhënies së vendimit nr.02, datë 16.02.2018, nuk ka patur kompetencë të vendosë ndërprerjen e procesit të rivlerësimit, përse kohë dorëheqja e magjistratit nuk mund të jepte efekte juridike.

Ky element i vendimmarrjes së Komisionit të Pavarur të Kualifikimit duhet të konsiderohet edhe në referencë të gërmës "a" të nenit 54 të ligjit nr.49/2012, i ndryshuar dhe pikës 6 të nenit 4 të ligjit nr.84/2016.

A handwritten signature in blue ink, appearing to read "Flavia Ballly", with a horizontal line drawn through it.

Nisur nga rëndësia që ka procedura që duhet të ndiqet për subjektet e rivlerësimit që japin dorëheqjen për t' i ikur procesit të rivlerësimit, afatit kohor për dhënien e dorëheqjes sipas nenit G të Aneksit të Kushtetutës, afat ky që bazuar në interpretimin e Gjykatës Kushtetuese nr.78/2017 zgjat përgjatë gjithë kohëzgjatjes 5 vjeçare së procesit të rivlerësimit, kjo trupë e nderuar këtë vendim gjyqësor do të duhet ta konsiderojë në cilësinë e një vendimi pilot, që do të rregullojë procedurat që ndiqen nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit në shumë raste të ngjashme, që do të mund të pasojnë dhe që do të mbartin të njëjtat karakteristika procedurale.

I marrë në të tilla rrethana ligjore dhe procedurale, vendimi nr.02, datë 16.02.2018 i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit duhet të priset, bazuar në gërmën "c" të nenit 66 të ligjit nr.84/2016.

Në referencë të analizës së mësipërme, Kolegji i Posaçëm i Apelit duhet t' i lërë detyrë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit të marrë edhe njëherë në shqyrtim rrethanat ligjore dhe procedurale për të konkluduar në rast se plotësohen ose jo kërkesat kushtetuese dhe ligjore për ndërprerjen e procesit të rivlerësimit ndaj z Adriatik Llalla, ekzistenca e të cilave mund të legjitimojë eventualisht



kompetencën e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit të vendosë duke zbatuar dispozitën e nenit G të Aneksit të Kushtetutës.

E nderuar gjykatë,

Dy shkaqet e tjera të parashtruara në ankimin kundër vendimit nr.02, datë 16.02.2018 të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit kanë të bëjnë me aspekte procedurale, që në vlerësimin e Komisionerit Publik, kërkojnë një orientim të praktikës, nëpërmjet vendimit gjyqësor të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, si kolegji i dytë i Gjykatës Kushtetuese.

Ndalimi i parashikuar nga paragrafi i dytë i nenit G të Aneksit të Kushtetutës, për të gjithë subjektet e rivlerësimit që japin dorëheqjen, në vendimin e mësipërm të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit është parashtruar vetëm në pjesën arsyetuese të tij.

Rezulton që në vendime të mëpasshme, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, ndalimin e parashikuar nga paragrafi i dytë i nenit G të Aneksit të Kushtetutës, nuk e ka bërë pjesë as të arsyetimit.



Mbetet për t' u interpretuar gjyqësisht nga ky Kolegj i nderuar, organi kompetent, procedura dhe materializimi në akt, i ndalimit të parashikuar nga paragrafi i dytë i nenit G të Aneksit të Kushtetutës.

Po ashtu, praktika e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit ka njohur vendimmarrje mbi bazë dokumentash, pa u zhvilluar seanca dëgjimore me subjektin.

Edhe ky element procedural në vlerësimin tonë, kërkon një interpretim gjyqësor nga ana juaj, duke marrë në konsideratë nevojën e respektimit të parimit të procesit të rregullt ligjor, jo thjesht dhe vetëm përsa i takon garantimit të lirive dhe të drejtave të subjekteve të rivlerësimit, por dhe të garantimit të aksesit të publikut në një proces, që sic e kemi përsëritur ka në themel të tij rikthimin e besimit të publikut tek sistemi i drejtësisë.

Ju faleminderit,

KOMISIONERI PUBLIK



Florian Ballhysa
Florian BALLHYSA

16/05/2018
20/20